

Në bazë të Marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë, Marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Ukrainës, Marrëveshjes së tregtisë së ëirë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe shteteve të EFTA-s, Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe bashkësive evropiane, Protokollit për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe nenin 36 paragrafi (3) të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 59/00, 12/03, 55/05, 37/06, 115/07, 19/08, 82/08, 10/10, 51/11, 15/13, 139/14, 196/15, 142/16 dhe 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 29 tetor të vitit 2019, miratoi

VENDIM PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E SHPËRNDARJES SË MALLRAVE NË KORNIZAT E KUOTAVE TARIFORE

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Ky vendim përcakton mënyrën dhe procedurën për shpërndarjen e mallrave brenda kuotave tarifore për importet preferenciale në përputhje me Marrëveshjen e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë, Marrëveshjen e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Ukrainës, Marrëveshjen e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe shteteve të EFTA-s, Marrëveshjen e stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe bashkësive evropiane, Protokollin për aderimin e Republikës së Maqedonisë në Organizatën Botërore të Tregtisë (në tekstin e mëtejme: mallrat).

Neni 2

Gjatë importimit të mallrave të përmendura në nenin 1 të këtij vendimi, pagesa e detyrimeve të importit do të bëhet në përputhje me marrëveshjet e tregtisë së lirë, Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe bashkësive evropiane dhe Protokollin për aderimin e Republikës së Maqedonisë në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Neni 3

Kur importohen mallrat e përmendura në nenin 1 të këtij vendimi, do të përdoret parimi "i pari i ardhur i pari i shërbyer" (first come, first served), në përputhje me marrëveshjen, kontratën dhe protokollin e lidhur për tregtinë e lirë.

Neni 4

Listat e mallrave me sasi të përcaktuara tremujore për të cilat bëhet shpërndarja publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" një herë në vit nga Ministria e Ekonomisë. Sasitë e papërdorura të mallrave në fund të çdo tremujori transferohen në tremujorin e parë të radhës përveç sasisë së përcaktuar të mallrave nga lista e mallrave në kuota tarifore.

II. PROCEDURA E SHPËRNDARJES SË MALLRAVE SIPAS PARIMIT I PARI I ARDHUR, PËRDORUESI I PARË

Neni 5

Për mallrat që i nënshtrohen përdorimit të importeve preferenciale në kuadër të një kuote tarifore, parashtrohet deklaratë elektronike doganore me të dhënat e numrit të kuotave të plotësuara në mënyrë përkatëse, që do të konsiderohet kërkesë e vlefshme për shpërndarjen e kuotave tarifore.

Deklarimi elektronik doganor i përmendur në pikën 1 të këtij neni do të dorëzohet nëpërmjet Sistemit elektronik për përpunimin e deklaratave dhe dokumenteve të akcizës (në tekstin e mëtejme: SOCDAD) parashtrohet deri te një nga zyrat doganore si vijon:

Emri i zyrës doganore	Shifra
------------------------------	---------------

I. ZYRA DOGANORE SHKUP	MK001000
Zyra doganore SHKUPI 1	MK001010
Zyra doganore SHKUP 3	MK001013
Zyra doganore SHKUPI 1	MK001014
Zyra doganore SHKUP 3	MK001015
Zyra doganore Bllacë-Dega për qarkullimin e mallrave	MK001075
II. ZYRA DOGANORE KUMANOVË	MK002000
Zyra doganore KUMANOVË	MK002010
Zyra doganore TABANOC AUTOSTRADA -Dega për qarkullimin e mallrave	MK002030
Zyra Doganore DEVE BAIR-Dega për qarkullimin e mallrave	MK002050
III. ZYRA DOGANORE SHTIP	MK003000
Zyra doganore SHTIP	MK003010
Zyra doganore DELLÇEVË - Dega për qarkullimin e mallrave	MK003030
Zyra doganore VELES	MK003050
IV. ZYRA DOGANORE E GJEVGJELISË	MK004000
Zyra doganore GJEVGJELI	MK004020
Zyra doganore KAVADAR	MK004040
Zyra doganore STRUMICË	MK004050
Zyra doganore NOVO SELLE - Deka për qarkullimin e mallrave	MK004060
V. ZYRA DOGANORE MANASTIR	MK005000
Zyra doganore MANASTIR	MK005010
Zyra Doganore MEXHITLIA - Deka për qarkullimin e mallrave	MK005020
Zyra doganore STRUGË	MK005060
Zyra doganore QAFË THANË - Dega për qarkullimit të mallrave	MK005070

Neni 6

Drejtoria Doganore shpërndan kuotat tarifore çdo ditë pune në orën 3 pasdite përmes Sistemit elektronik për mjedis të integruar tarifor (në tekstin e mëtejshëm: ITO).

Pranimi i Deklaratave elektronike doganore do të bëhet në përputhje me nenin 216 paragrafi (7) të Urdhërësës për zbatimin e Ligjit doganor.

Të gjitha deklaratat elektronike doganore të kuotave tarifore të parashtruara gjatë një dite kalendarike do të konkurrojnë në mënyrë të barabartë për shpërndarjen e kuotës së normës së mbetur tarifore.

Nëse sasi të e kërkuara për shpërndarje sipas kuotës tarifore janë më të mëdha se sasia e disponueshme, shpërndarja do të bëhet në proporcion me sasi të e kërkuara në të njëjtën datë.

Neni 7

Mallrat që gjenden në procedurës tranzite, të cilat janë ruajtur përkohësisht ose që kanë qenë në magazinim doganor në vitin paraprak kalendarik, mund të marrin pjesë në ndarjen e kuotave tarifore për vitin aktual kalendarik.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 8

Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi, do të pushojë së zbatuari Vendimi për mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mallrave brenda kuotave tarifore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.101/07, 168/08, 26/10, 6/11, 122/11, 5/12, 53/12, 53/13 dhe 31/15).

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 18.11. të vitit 2019.

Nr. 45-7147/1
29.10.2019
12, 1000 Shkup,

Zv. Kryetar i
Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut
dr. **Koço Angjushev**, n.d.